



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.74**

**30 qershor**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK nr.28, datë 27.5.2010	Me objekt: a) Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.521, datë 13.05.2009 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre”, në pjesën integrale lista e çmimeve të barnave që rimbursohen në rubrikën “Referenca”. b) Pezullimi i zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.521, datë 13.05.2009, në pjesën e aktit objekt shfuqizimi në këtë kërkesë (rubrika “çmimi referencë” i listës së barnave të rimbursuara).....	3937
Vendim i GJK nr.29, datë 31.5.2010	Me objekt: 1. Shfuqizimi si antikushtetues i ligjit nr.9948, datë 7.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”. 2. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr.9948, datë 7.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”.....	3942
Vendim i GJK nr. 30, datë 17.6.2010	Me objekt shfuqizimi i nenit 48, paragrafi i tretë dhe i nenit 410, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale si të papajtueshëm me nenin 43 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.....	3951
Vendim i ERE nr.45, datë 7.6.2010	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Elektro Lubonja” sh.p.k.....	3961

**VENDIM**  
**Nr.28, datë 27.5.2010**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 10.12.2009 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.28/17, që i përket

**KËRKUES: SHOQATA E DISTRIBUTORËVE FARMACEUTIKË TË SHQIPËRISË,** përfaqësuar nga av. Vangjel Kosta, me prokurë.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

**KËSHILLI I MINISTRAVE,** përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË,** përfaqësuar nga Sokol Frroku, Andoneta Njehrrrena dhe Ahmet Hysa, me autorizim.

**OBJEKTI:** a) Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.521, datë 13.05.2009 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre”, në pjesën integrale lista e çmimeve të barnave që rimbursohen në rubrikën “Referenca”.

b) Pezullimi i zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.521, datë 13.05.2009, në pjesën e aktit objekt shfuqizimi në këtë kërkesë (rubrika “çmimi referencë” i listës së barnave të rimbursuara).

**BAZA LIGJORE:** Nenet 11, 17, 131 germa “c”, 134, 1 “f” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 27-30, 45, 49-51 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi; përfaqësuesin e Shoqatës së Distributorëve Farmaceutikë të Shqipërisë (SHDFSH) që kërkoi pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e saj, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Në datë 13.05.2009 Këshilli i Ministrave (KM) ka miratuar vendimin nr.521 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre”, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së RSH, të neneve 4 dhe 15 të ligjit nr.7870 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.10025 “Për Buxhetin e Shtetit”. Ky vendim miraton listën e barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) dhe masën e mbulimit të çmimeve të barnave që rimbursohen.

2. Në datën 25.06.2009, SHDFSH, iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për të shfuqizuar vendimin e Këshillit të Ministrave nr.521, datë 13.05.2009, në pjesën e aktit objekt

shfuqizimi në këtë kërkesë (rubrika “çmimi referencë” i listës së barnave të rimbursuara), si dhe për të pezulluar zbatimin e aktit të mësipërm deri në dhënien e vendimit përfundimtar të kësaj Gjykate.

3. *Kërkuesi* pretendon se:

- Vendimi objekt shqyrtimi cenon parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të proporcionalitetit të mbrojtura nga nenet 11 dhe 17 të Kushtetutës, pasi çmimi i përcaktuar në këtë vendim të KM përbën një ndërhyrje joproporcionale dhe dikton kushte të padrejta për veprimtarinë ekonomike të tregtimit të barnave me shumicë. Çmimet e vendosura nga Këshilli i Ministrave përfaqësojnë një masë të karakterit monetar, e cila në vetvete konsiderohet një lloj kufizimi. Çmimet e përcaktuara nga vendimi objekt shqyrtimi krijojnë pamundësi për tregtimin e një pjese të barnave (të cilat duhet të shiten detyrimisht nën kosto) dhe shitjen e barnave të tjera me çmim që nuk krijon pritshmëritë e planifikuara në aktivitetin tregtar dhe, për rrjedhojë, krijon vështirësi të mëdha në administrimin e kësaj veprimtarie.

- Vendimi i KM, objekt shqyrtimi, duhet të pezullohet deri në dhënien e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, pasi nga analiza e fakteve dhe e akteve nënligjore rezultojnë se zbatimi i këtij akti normativ krijon vështirësi shumë të mëdha në veprimtarinë ekonomike-tregtare të anëtarëve të shoqatës kërkuese dhe, për rrjedhojë, sjell pasoja nga ato të kërkuara nga neni 45 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

4. *Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave* kërkoi rrëzimin e kërkesës duke parashtruar se:

- SHDFSH nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sepse në kërkesën e paraqitur për shqyrtim nuk ka arritur të argumentojë lidhjen e çështjes me interesat e veta dhe cenimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë. Interesi që duhet të ketë subjekti kërkues konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real apo potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës.

- Vendimi i KM, objekt shqyrtimi, në zbatim të detyrimeve ligjore, nuk ka rregulluar kontrollin e çmimit të barnave apo përcaktimin e çmimit të barnave sikurse pretendohet në kërkesë, por listën e barnave që rimbursohen dhe masën e mbulimit të çmimit të barnave që përfshihen në listë. Pra, qëllimi i këtij vendimi është rimbursimi i barnave dhe jo përcaktimi i çmimit të shitjes së barnave. Kërkesa e paraqitur para Gjykatës Kushtetuese paraqet lajthim në objekt. Rubrika, pjesë e këtij vendimi, përcakton çmimin referencë mbi bazën e të cilit caktohet vlera që merr përsipër shteti për të rimbursuar nga çmimi i barnave dhe vlera që paguhet nga vetë pacienti. Në asnjë nga 8 pikat e vendimit nuk përcaktohet detyrimi i farmacistëve për të tregtuar barnat, sipas çmimeve të përcaktuara në tabelat bashkëlidhur tuj.

- Kuadri ligjor që përcakton çmimin e barnave është i ndryshëm nga ai që kundërshton kërkuesi. Nuk ka shkelje të nenit 11 të Kushtetutës nga vendimi objekt shqyrtimi, pasi kufizimi lidhur me çmimin e barnave është vendosur në ligj. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përcaktojë çmimin e barnave në bazë të ligjit nr.9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” (ligji për barnat). Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.56, datë 28.01.2005 ka përcaktuar se konvertimi bëhet sipas kursit mesatar të njoftuar nga Banka e Shqipërisë. Në hartimin e vendimit objekt shqyrtimi është mbajtur në konsideratë mesatarja e kursit të këmbimit për atë gjashtëmuor, sipas njoftimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Për arsye të luhatjes së kursit të këmbimit, vendimet që parashikojnë masën e rimbursimit nga shteti, miratohen çdo vit nga Këshilli i Ministrave.

5. *Subjekti i interesuar, Ministria e Shëndetësisë*, parashtrroi se kërkesa duhet rrëzuar pasi:

- Neni 50 i ligjit për barnat parashikon se çmimi i barnave në treg është i kontrolluar, bazohet mbi çmimet CIF të importit dhe mbi bazën e çmimeve të fabrikimit për barnat e prodhuara në vend. Marzhet e fabrikimit të barnave në treg dhe çmimet e barnave të listës së rimbursimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Komisioni i çmimit të barnave, i cili funksionon si njësi e përhershme në Ministrinë e Shëndetësisë, miraton çdo vit kalendarik çmimet maksimale në CIF (në euro ose dollarë) për barnat e importit dhe çmimet e fabrikimit në lekë për barnat e prodhuara në vend. Çmimet CIF deklarohen nga fabrikuesit apo përfaqësuesit e tyre në Shqipëri brenda datës 31 tetor të çdo viti.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave, objekt shqyrtimi, ka dalë në zbatim të neve 4 dhe 15 të ligjit nr.7870, datë 13.04.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji për sigurimet shëndetësore) dhe ka miratuar listën e barnave që do të rimbursohen gjatë vitit 2009. Çdo vit ka dalë një vendim i Këshillit të Ministrave për këtë qëllim. Një vendim i tillë pritet të miratohet dhe për vitin 2010. Mënyra e përgatitjes së kësaj liste dhe formula se si do të llogariten çmimet në këtë listë përcaktohen në ligjin për barnat.

## II

*A. Lidhur me legjitimitetin e Shoqatës së Distributorëve Farmaceutikë të Shqipërisë për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese sipas objektit të kërkesës*

6. Gjykata Kushtetuese (Gjykata), në jurisprudencën e saj ka interpretuar kriteret kushtetuese për legjitimitetin e organizatave si subjekte që mund ta vënë atë në lëvizje (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9/2007; nr.11/2007; nr.35/2007; nr.41/2007; nr.9/2008, nr. 12/2009*). Shoqatat ose organizatat e tjera janë përcaktuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007*). Ato kanë detyrimin të provojnë lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak.

7. SHDFSH është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.4199, datë 26.12.2000. Anëtarë të kësaj shoqate janë shoqëritë tregtare që ushtrojnë aktivitet ekonomik në tregun e farmaceutikës në Shqipëri. Në Statutin e Shoqatës parashikohet, ndër të tjera, se qëllimi kryesor i saj është “...mbrojtja dhe ruajtja e interesave ekonomikë të anëtarëve të saj para organizatave të tjera shtetërore brenda dhe jashtë vendit”. Pra, shoqata kërkuese është organizatë që mbron interesat ekonomikë të anëtarëve të saj, persona juridikë që ushtrojnë aktivitet ekonomik në fushën përkatëse. Kuadri ligjor dhe nënligjor i lidhur me normimin e çmimeve të barnave përbën objektin e veprimtarisë së tyre dhe prezumohet të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetin ekonomik të anëtarëve të shoqatës. Interesi vlerësohet të jetë aktual me argumentin se për një VKM të pretenduar si antikushtetues, interesi për kundërshtimin e tij para Gjykatës Kushtetuese konsiderohet i lindur që në çastin e marrjes së fuqisë juridike të aktit, me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

8. Bazuar në sa më sipër Gjykata vlerëson se VKM objekt shqyrtimi ka një lidhje të drejtpërdrejtë me veprimtarinë ekonomike të anëtarëve të shoqatës kërkuese, prandaj kjo shoqatë mbart interesin për ta kundërshtuar këtë VKM (në pjesën e përshkruar në objektin e kërkesës), e për rrjedhojë legjitimohet në lidhje me pretendimet për shkelje të neneve 11/3 dhe 17/1 të Kushtetutës.

*B. Lidhur me kërkesën për pezullimin e zbatimit të VKM, objekt i kërkesës*

9. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.521, datë 13.05.2009 në pjesën e aktit objekt shfuqizimi në këtë kërkesë (rubrika “çmimi referencë” i listës së barnave të rimbursuara). Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, u vendos rrëzimi i kërkesës. Gjykata nuk gjeti argumente bindëse për mundësinë e cenimit të interesave shtetërorë, shoqërorë ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të këtij vendimi.

*C. Lidhur me pretendimin se vendimi, objekt i kërkesës, cenon parimin kushtetues të lirisë së veprimtarisë ekonomike*

10. Kërkuesi pretendon se VKM, objekt shqyrtimi, cenon parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të proporcionalitetit të mbrojtura nga nenet 11 dhe 17 të Kushtetutës, me argumentin se çmimi i përcaktuar në vendimin objekt shqyrtimi përbën një ndërhyrje joproporcionale të Këshillit të Ministrave pasi dikton kushte të padrejta për veprimtarinë ekonomike të tregtimit të barnave me shumicë. Çmimet e vendosura nga autoritete publike si Këshilli i Ministrave përfaqësojnë një masë të karakterit monetar, e cila në vetvete konsiderohet një lloj kufizimi.

11. Gjykata rithekson se liria e veprimtarisë ekonomike, garantuar nga neni 11 i Kushtetutës nënkupton kryesisht të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe shërbimeve. Forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton të drejtën e pronës, lirinë pa asnjë kufizim të qarkullimit të fuqisë punëtore, të kapitalit dhe të mallrave; se individi ka të drejtë të punojë, të prodhojë, të konsumojë dhe të investojë në çdo mënyrë që i pëlqen dhe kjo liri duhet të mbrohet nga shteti. Liria e veprimtarisë ekonomike përbëhet në vetvete shumë të drejta dhe liri, si: liria e biznesit ose aftësia për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, liria e tregtisë ose mungesa e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, liria monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të çmimit, liria fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende të lirë nga ndërhyrja e shtetit, liria e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj, liria financiare dhe pavarësia nga kontrolli shtetëror, liria e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 19.03.2008*).

12. Gjykata është shprehur se liria e veprimtarisë ekonomike nënkupton edhe detyrimin e shtetit që, nëpërmjet legjislacionit, të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie me qëllim që, krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike, të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i së mirës së përbashkët. Ky detyrim për rregullim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara. Vetëm shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet që natyrshëm mund t'i mbart me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike (*shih vendimin nr. 10, datë 19.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata ka sqaruar edhe kriteret në bazë të të cilave shteti mund të ndërhyjë për të rregulluar ushtrimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike sipas këtij neni të Kushtetutës. Ajo është shprehur, se nisur nga struktura e Kushtetutës, e veçanta e nenit 11 paragrafi 3 është se ai nuk është parashikuar në grupin e të drejtave dhe lirive të tjera, por në pjesën ku parashikohen parimet themelore mbi të cilat mbështetet organizimi dhe funksionimi i shtetit.

14. Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar cenimin ose jo të lirisë ekonomike duke iu referuar edhe përmbajtjes së nenit 17/1 të Kushtetutës, e cila shtrihet ndaj të gjitha të drejtave dhe lirive të parashikuara në të, sipas të cilit "...kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë". Kjo dispozitë, përveç arsyes publike, të cilën e gjejmë edhe tek neni 11/3, përbëhet detyrimin për të respektuar edhe kriteret e tjera, si: kufizimi për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë. Parimi i njohur i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte apo lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.03.2008*).

15. Gjykata e ka sqaruar edhe më parë kuptimin e shprehjes "vetëm me ligj". Shprehja "vetëm me ligj" ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, vlerësimi për të është diskrecion vetëm i Kuvendit dhe jo i organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave. Në këtë përfundim arrihet edhe duke iu referuar fjalës "vetëm" që përmendin nenet 11/3 e 17/1 të Kushtetutës. Përdorimi i kësaj fjale nuk është rastësor, por me qëllimin për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit. Gjykata Kushtetuese ka çmuar se shprehja "vetëm me ligj" referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla, cenon kompetencat e këtij organi (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 11.07.2006*).

16. Duke iu referuar kushteve të nenit 17/1 në lidhje dhe me nenin 11/3 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson edhe kriterin e kufizimit për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes legjislative, të cilët, si rregull, bashkërendohen

dhe plotësohen nga njëri-tjetri. Lidhur me interesin publik, Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar se pranohen si kufizime të arsyeshme të lirisë së veprimtarisë ekonomike iniciativat e ligjvënësit, të cilat shërbejnë për një rregullim të tregut apo interesave të një shteti social. Këto masa të ligjvënësit mund të jenë të shumëllojshme, madje edhe të karakterit monetar, si p.sh. vendosja e tatimeve dhe taksave, e cila në vetvete konsiderohet si një lloj kufizimi. Në përgjithësi garantimi i mundësisë së individit për të zgjedhur lirisht fushën e veprimtarisë së tij (iniciativa ekonomike) dhe për të realizuar idetë e tij mbi aktivitetin ekonomik që ai ka zgjedhur është konsideruar i mjaftueshëm. Ajo që ka rëndësi është që thelbi i aktivitetit të individit të mos cenohet deri në atë masë sa të bëhet i pamundur ushtrimi i tij (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.03.2008*).

17. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson fillimisht nëse vendimi i KM-së, objekt shqyrtimi, kufizon lirinë ekonomike të anëtarëve të subjektit kërkues. Vlerësimi përfshin më pas elementet nëse kufizimi i pretenduar është bërë sipas kriterëve të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë, pra me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe, në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

18. Vendimi, objekt i shqyrtimit kushtetues, ka dalë në zbatim të neneve 4 dhe 15 të ligjit nr.7870 datë 13.04.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në nenin 4 pika 3 të ligjit parashikohet, ndër të tjera, se masa e mbulimit të çmimit të barnave kryesore përcaktohet çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Neni 15 i ligjit parashikon se lista e barnave të rimbursueshme nga ISKSH miratohet me vendim të KM-së, pasi është përcaktuar më parë nga ISKSH. Rregullimi dhe kontrolli mbi çmimet e barnave rregullohet nga neni 50 i ligjit nr.9323, datë 25.12.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, i cili përcakton se çmimi i barnave në treg është i kontrolluar dhe bazohet mbi çmimet CIF të importit dhe mbi bazën e çmimeve të fabrikimit për barnat e prodhuara në vend; kontrolli i çmimit të barnave në treg realizohet përmes marzheve të fabrikimit e të tregtimit që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave; çmimet e barnave të listës së rimbursimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

19. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se mënyra e përgatitjes së kësaj liste, si dhe formula se si do të llogariten çmimet në këtë listë përcaktohen në ligjin për barnat dhe në vendimin e KM-së nr.504, datë 8.08.2007 “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të çmimit të barnave” dhe vendimin e KM-së nr.56, datë 28.01.2005 “Për përcaktimin e marzheve të fabrikimit dhe të tregtimit të barnave”. Komisioni i Çmimit të Barnave i Ministrisë së Shëndetësisë miraton çdo vit kalendarik çmimet maksimale CIF (në euro ose dollarë) për barnat e importit dhe çmimet e fabrikimit (në lekë) për barnat e prodhuara në vend.

20. Gjykata vëren se vendimi objekt shqyrtimi është një akt i nxjerrë në mbështetje të ligjit për sigurimet shëndetësore, i ndryshuar dhe ligjit për buxhetin e shtetit 2009. Ai përcakton marzhet e diferencuara të listës së barnave që rimbursohen në bazë të mekanizmit/formulës së përcaktuar në aktet e sipërcituara. Në këto kushte Gjykata vlerëson se nëse ka kufizim të veprimtarisë së lirisë ekonomike këtë gjë e ka bërë ligji për sigurimet shëndetësore dhe për barnat dhe jo akti nënligjor objekt shqyrtimi. Këto dy ligje nuk janë objekt i këtij shqyrtimi kushtetues.

21. Për më tepër, kërkuesi nuk legjitimohet për të kërkuar kontrollin kushtetues të dy ligjeve të sipërpërmendur. Në nenin 50 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” parashikohet se kërkesat lidhur me shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare mund të paraqiten brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre. Gjykata vëren se ligji për sigurimet shëndetësore dhe ai për barnat kanë hyrë në fuqi më herët se tre vjet më parë nga data e depozitimit të kërkesës, objekt i këtij shqyrtimi kushtetues, dhe, në këto kushte, afati trevjeçar i parashikuar në ligjin për GJK ka kaluar.

22. Bazuar në sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit se vendimi nr.521, datë 13.05.2009 i KM-së cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike në mënyrë joproporcionale është i pabazuar dhe për rrjedhojë duhet rrëzuar.

## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja “c” dhe 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.521, datë 13.05.2009 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre”, në pjesën integrale lista e çmimeve të barnave që rimbursohen, në rubrikën “referenca”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Vladimir Kristo (kryetar), Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Ploçi, Sokol Berberi, Admir Thanza

## VENDIM Nr.29, datë 31.5.2010

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Petrit Ploçi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 22.09.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.19/10 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** AVOKATI I POPULLIT, përfaqësuar nga Florina Nuni dhe Frederik Paskali me autorizim.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.

**KËSHILLI I MINISTRAVE,** përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

**NAZMI DRIZA,** në mungesë.

**SHOQËRIA “DUDAJ” SHPK,** në mungesë.

**OBJEKTI:** 1. Shfuqizimi si antikushtetues i ligjit nr.9948, datë 7.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”.

2. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr.9948, datë 7.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, dhe vendimit të Këshillit të

Ministrave nr.1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 15, 17, 18, 41 e 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27-30, 39, 45 e 49/2 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; neni 24/c i Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Petrit Pllloçi; përfaqësuesit e kërkuarit, që kërkuar pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë, që kërkuar rrëzimin e saj dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

Me ligjin nr.9948, datë 7.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” (këtu e më pas ligji nr. 9948), objekt i këtij gjykimi kushtetues, është parashikuar shqyrtimi i vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, janë përcaktuar strukturat shtetërore të ngarkuara për këtë qëllim, si dhe detyrat e përgjegjësitë e këtyre strukturave.

Për efekt të zbatimit të këtij ligji, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr.1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”.

Sipas kërkuarit, pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur ankesa nga persona fizikë dhe juridikë (ai përmend 2 prej tyre), në të cilat shprehet shqetësimi lidhur me zbatimin e ligjit nr. 9948 dhe ku pretendohet se fryma e këtij ligji në tërësi dhe nene të veçantë të tij janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Në këto kushte, *Avokati i Popullit i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e ligjit objekt kërkesë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:*

Ligji është në kundërshtim me *parimin e sigurisë juridike*, sepse krijon ambient pasigurie për një masë shumë të madhe pronarësh, humbet besueshmërinë e shtetasve të shteti, nuk jep garanci për vijueshmëri dhe për ndryshime legjislacioni në përputhje me Kushtetutën; me ligjin nr. 9948 organet administrative kanë të drejtë të verifikojnë, shqyrtojnë dhe anulojnë titujt e pronësisë të fituar me akte ligjore e nënligjore; ligji nuk merr parasysh afatet e parashkrimit të padisë dhe fitimin me parashkrim fitues të pronës me mirëbesim, të parashikuara në Kodin Civil; ligji ka fuqi prapavepruese, sepse autorizon komisionet aktuale në rang vendor të shfuqizojnë aktet e lëshuara nga komisionet e mëparshme, të ngritura mbi bazën e dispozitave ligjore në fuqi; ligji është në kundërshtim me nenin 7 të Kushtetutës, sepse me këtë ligj *organet e pushtetit ekzekutiv kanë marrë kompetenca të pushtetit gjyqësor*; ligji është në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës, sepse verifikimi i vlefshmërisë së titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore bëhet pa një proces të rregullt gjyqësor; ligji është në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), sepse askush nuk mund të shpronësohet ose t’i kufizohet e drejta e ushtrimit të së drejtës së pronës që barazohet me shpronësimin, përveçse kur këtë e kërkojnë interesat publikë.

*Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë të përmbledhur parashtrroi se:*

*i) në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit*

Kërkuari mbetet një nga subjektet që e vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij; kërkuari merr rolin procedural të përfaqësuesit të një personi juridik dhe



të një shtetasi, duke përcjellë pretendimet e tyre për një gjykim abstrakt kushtetues; kërkuesi nuk jep asnjë argument se zbatimi i ligjit, objekt gjykimi, ka shkelur të drejtat e njeriut, çka është në detyrimin e tij si palë kërkuese për shkak të barrës së provës; kërkuesi duhet të argumentonte se ka përdorur instrumentet ligjore për hetimin e rasteve dhe marrjen e masave për eliminimin e shkeljeve të pretenduara, duke argumentuar se e vetmja mundësi është vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese, për gjykim abstrakt, për shfuqizimin e ligjit.

*ii) në lidhje me themelin e kërkesës*

Ligji nr. 9948 bën vetëm verifikimin e titujve të pronësisë të marrë në përputhje me legjisllacionin në fuqi për tokën bujqësore; ligji i kundërshtuar nuk shkel parimin e sigurisë juridike pasi nuk cenon aspak një të drejtë të mëparshme; në asnjë rast ligji nuk parashikon që komisioni vendor të marrë përsipër çështje për të cilat vendimet e gjykatave janë të formës së prerë; dispozitat e këtij ligji janë në harmoni me dispozitat dhe parimet themelore të ligjit nr. 7501 dhe ai garanton që titujt e pronësisë mbi tokën bujqësore të jenë marrë pikërisht mbi bazën ligjore të kohës dhe të jenë lëshuar nga organet kompetente; parashikimi në këtë ligj i njohjes të së drejtës së ankimit në gjykatat e sistemit gjyqësor të vendimeve administrative, jo vetëm nuk përbën cenim të parimit kushtetues të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, por garanton pavarësinë e gjykatave dhe mosndërhyrje në interpretimin e ligjit dhe marrjen e vendimit; ligji i kundërshtuar nuk shkel të drejtën e pronës të sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës dhe as mënyrat e fitimit të pronësisë; ky ligj nuk iu heq të drejtën e pronësisë atyre që e kanë fituar konform dispozitave ligjore në fuqi, si dhe atyre që e kanë fituar me vendime gjyqësore të formës së prerë; ligji nuk cenon nenin 42 të Kushtetutës, sepse ai nuk pengon asnjë subjekt t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar apo rivendosur të drejtën e tij të shkelur apo të cenuar; dispozitat përkatëse të ligjit parashikojnë gjykatën si hallkën e fundit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; interesi publik që e ka çuar ligjvënësin drejt nevojës së nxjerrjes së ligjit objekt shqyrtimi, ka qenë i tillë që e justifikon ndërhyrjen e tij; evidentimi, konstatimi dhe eliminimi i gabimeve, parregullsive, shkeljeve ligjore dhe abuzimeve të qëllimshme gjatë zbatimit të ligjeve të mëparshme në këtë fushë dhe nxjerrja e këtij ligji nga ligjvënësi i shërben interesit publik.

*Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, në mënyrë të përmbledhur, parashtroi se:*

*i) në lidhje me legjitimitimin e kërkuesit*

Avokati i Popullit nuk legjitimohet të vërë në lëvizje këtë gjykim kushtetues; ligji i kundërshtuar njeh të drejtën e rishikimit gjyqësor të procesit të zbatimit të këtij ligji nga organet e administratës gjyqësore me kërkesë të subjektit të prekur nga zbatimi i ligjit, rrjedhimisht mund të thuhet se kjo çështje mund të vinte në Gjykatën Kushtetuese prej gjykatave të sistemit të zakonshëm dhe jo nga Avokati i Popullit; kërkuesi ka zgjedhur mjetin më ekstrem të ushtrimit të veprimtarisë së tij, duke kapërcyer mjetet e tjera, si paraqitja e rekomandimeve apo propozimeve; Avokati i Popullit duhet të veprojë për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike; Avokati i Popullit ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për mbrojtjen e situatave në të cilat individi ka fituar të drejtën e pronësisë në mënyrë të paligjshme, ndërsa administrata ka vepruar në mënyrë të ligjshme dhe të rregullt.

*ii) në lidhje me themelin e kërkesës*

Ligji i kundërshtuar nuk cenon parimin e sigurisë juridike, por ai ka për qëllim të verifikojë ligjshmërinë e titujve të pronësisë mbi këto toka; ligji nuk merr përsipër të përkeqësojë situatën e subjekteve që kanë fituar titujt e pronësisë në mënyrë të ligjshme, përkundrazi merr përsipër të rivendosë të drejtat në situatat ku ligji është shkelur; fitimi i një të drejte nëpërmjet shkeljes së ligjit nuk mund të ruhet si gjendje nëpërmjet invokimit të parimit të sigurisë juridike; dispozitat e Kodit Civil, të pretenduara të shkeluara, trajtojnë rastet e pavlefshmërisë relative të veprimit juridik në ndryshim nga ligji nr. 9948, i cili flet për raste të pavlefshmërisë absolute; pretendimi për cenimin e nenit 7 të Kushtetutës është jashtë rrethit të çështjeve që lejohet të ngrejë Avokati i Popullit përpara Gjykatës; neni 41 i Kushtetutës merr në mbrojtje të drejtën e pronësisë të fituar me dhurim, trashëgimi, me blerje dhe çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil, kurse ligji nr. 9948 godet dhe shfuqizon titujt e pronësisë të fituara në mënyrë antikushtetuese dhe antiligjore; subjektet që preken nga zbatimi i ligjit nuk janë pronarë dhe nuk mund të konsiderohen kurrë

pronarë për shkak se titulli i pronësisë është fituar prej tyre në shkelje të ligjit; edhe në eventualitetin që Gjykata Kushtetuese do të pranojë se ligjvënësi, nëpërmjet ligjit nr. 9948, ka ndërhyrë në të drejtën e pronësisë së individit, kjo ndërhyrje është në përputhje me standardet e vendosura nga Kushtetuta në nenin 17 të saj dhe nga praktika e GJEDNJ-së; neni 42 i Kushtetutës përmend “procesin e rregullt ligjor”, çka tregon qëllimin e ligjvënësit për të vepruar qoftë me proces gjyqësor, qoftë me proces administrativ; ligji nr. 9948 nuk mohon të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, madje parashikon akses shumë të mirë të individit në gjykatë.

## II

Gjykata Kushtetuese (Gjykata), mori paraprakisht në shqyrtim, përpara seancës plenare, kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit nr.9948, datë 7.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me vendimin e datës 17.07.2009, mbledhja e gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim, për arsye se nuk gjeti argumente bindëse për cenimin e interesave shtetërorë, shoqërorë ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të këtyre akteve normative.

## III

*Lidhur me pretendimin e subjekteve të interesuara për mungesën e legjitimitetit të kërkuarit për të iniciuar gjykimin kushtetues*

Gjykata vëren se Kushtetuta, në nenin 134, pika 1, germa “dh”, ka përfshirë Avokatin e Popullit në rrethin e subjekteve që mund të iniciojnë një gjykim kushtetues abstrakt të normës, por vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij.

Sipas nenit 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Pra, edhe interesi i tij për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron kur, si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve. Këto shkelje duhet të evidentohen në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.40, datë 16.11.2007*).

Gjykata Kushtetuese vëren gjithashtu se Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individëve edhe kur shkelja e tyre vjen si rezultat i vetëpërmbajtjes së këtyre ligjeve apo akteve, d.m.th. kur këto ligje/akte janë në kundërshtim me Kushtetutën. Në këtë rast ai ka të drejtë t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve apo, të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla.

Gjykata vëren gjithashtu se interesi i Avokatit të Popullit për ta vënë atë në lëvizje në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet të shqyrtohet rast pas rasti. Gjykata Kushtetuese është shprehur dhe më parë në praktikën e saj se interesi i një subjekti në një çështje, në kuptim të germave “dh”, “e” “ë”, “f” të nenit 134 të Kushtetutës, do të quhet i justifikuar nëse arrin të provohet nga vetë kërkuari se pasoja është e drejtpërdrejtë, pra rrjedh direkt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale dhe, sipas rastit, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit ose organizatës respektive (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.40, datë 16.11.2007*).

Për sa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkuari i plotëson këto kritere dhe, për rrjedhojë, legjitimohet të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues.

#### IV

##### *1. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike (neni 4 i Kushtetutës)*

Pala kërkuese, Avokati i Popullit, ka pretenduar se ligji nr. 9948 është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, sepse krijon ambient pasigurie për një masë pronarësh, humbet besueshmërinë e shtetasve të shteti, nuk jep garanci për vijueshmëri dhe për ndryshime legjislativore në përputhje me Kushtetutën; me disa akte ligjore e nënligjore shumë subjekte kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore, ndërsa me ligjin nr. 9948 organet administrative kanë të drejtën të verifikojnë, shqyrtojnë dhe anulojnë titujt e pronësisë; ligji nuk merr parasysh afatet e parashkrimit të padisë dhe fitimin me parashkrim fitues të pronës me mirëbesim, të parashikuara në Kodin Civil; ligji ka fuqi prapavepruese në momentin që autorizon komisionet aktuale në rang vendor të shfuqizojnë aktet e lëshuara nga komisionet e mëparshme të ngritura mbi bazën e dispozitave ligjore në fuqi.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimi i mësipërm duhet të shqyrtohet në kuadrin e parimit kushtetues të shtetit të së drejtës. Me këtë rast Gjykata rithekson se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet themelore në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Aspekte të këtij parimi janë edhe siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara dhe e pritshmërive të ligjshme. Siguria juridike presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 12.11.2008; nr.9, datë 26.02.2007*). Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijueshmëri të tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislativ dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre duhet të synojë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007; nr.34, datë 20.12.2005*). Ky parim përfshin, midis të tjerave, edhe besimin tek sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situatë të favorshme ligjore (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.03.2008; nr.34, datë 20.12.2005; nr.26, datë 02.11.2005*).

Gjykata Kushtetuese rithekson se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, kjo Gjykatë nisat nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se, lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar, duhet të parashtrihen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të aplikuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.16, datë 25.07.2008*).

Gjykata çmon se Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, apo t'u përgjigjet prioritetëve apo problemeve të ndryshme të vendit. Megjithatë, duhet të ritheksohet se ligjet apo dispozitat të veçanta të tyre, të miratuara nga ligjvënësi për këtë qëllim, nuk duhet të vijnë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës.

Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese vëren se, mes ndryshimeve në legjislativ që janë kryer në Shqipëri nga fillimi i viteve 90-të, është edhe miratimi i legjislativorit që kishte për qëllim tranzicionin nga ekonomia socialiste në atë të tregut të lirë. Për këtë ligjvënësi ka miratuar një seri ligjesh, mes të cilëve edhe ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën". Objekt i rregullimit të këtij ligji ishte toka bujqësore që administrohej nga ish-kooperativat bujqësore, e cila iu dha në pronësi ose në përdorim personave juridikë a fizikë vendas pa shpërblim. Pas vitit 1992 filluan procedurat e ndarjes së tokës bujqësore edhe në territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore (NB), duke u dhënë në përdorim, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 17.10.1992 "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore". Në vitin 1995, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr.8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", duke përcaktuar kriteret dhe mënyrën e kalimit të tokës në pronësi. Ky ligj (neni 2) përjashtonte nga

dhënia në pronësi: tokat bujqësore që në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ndodheshin brenda vijës kufizuese të qyteteve, fshatrave ose qendrave të banuara; tokat bujqësore të përfshira në zonat me përparësi turizmin; tokat bujqësore të përfshira në veprimtarinë eksperimentale-shkencore të instituteve kombëtare shkencore; tokat bujqësore të dhëna në përdorim specialistëve të bujqësisë; tokat bujqësore të pushtuara ose fituara në mënyrë të paligjshme; tokat bujqësore në përdorim të ndërmarrjeve të përbashkëta, deri në zgjidhjen e kontratës së lidhur midis palëve ose mbarimin e afatit të saj. Si struktura përgjegjëse për ndarjen e tokës ligji përcaktonte komisionet e tokës të katër niveleve: komisioni qeveritar, komisioni i qarkut, komisioni i komunës dhe/ose bashkisë dhe komisioni i fshatit. Ndarja faktike e tokës dhe pajisja e familjeve bujqësore me “*aktin e marrjes së tokës në pronësi*”, pra për krijimin e titujve të pronësisë, i ishte ngarkuar komisionit të fshatit. Toka që kalonte në pronësi pa shpërblim regjistrohej në kadastër.

Gjykata Kushtetuese vë në dukje se ligji objekt shqyrtimi kushtetues është kundërshtuar në tërësi, megjithatë, nga arsyetimi i kërkesës dhe parashtrimet në seancë gjyqësore, rezulton se kërkesa për shfuqizim lidhet vetëm me nenet 2, 3, 4, 8, 9 dhe 10 të këtij ligji. Për pasojë, Gjykata duhet të shqyrtojë vetëm kushtetutshmërinë e këtyre dispozitave të ligjit të kundërshtuar.

Lidhur me nenet 2 (që përcakton se cilët tituj pronësie kanë vlefshmëri ligjore), 3 (kriteret për vlefshmërinë e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore) dhe 4 (procedurat dhe dokumentacioni i titullit të pronësisë) të ligjit të kundërshtuar shtrohet çështja nëse, në kuadrin e parimit të sigurisë juridike, ligji i kundërshtuar ka shtuar kriteret të reja për fitimin e pronësisë mbi tokën bujqësore, tej atyre kriterëve që njihnin ligjet e kohës, gjë që do të ishte në kundërshtim me këtë parim.

Në këtë drejtim Gjykata Kushtetuese konstaton se, nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme, nuk rezulton që ato të kenë shtuar kriteret të reja për fitimin e pronësisë mbi tokën bujqësore. Sipas këtyre dispozitave, verifikimi i ligjshmërisë së titujve të pronësisë do të bëhet vetëm mbi ato kriteret që parashikonin ligjet përkatëse të kohës. Për pasojë, ndërhyrja e ligjvënësit në këtë aspekt është në pajtim me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese vëren se edhe pretendimi i kërkuarit në lidhje me nenet 8 (detyrat dhe përgjegjësitë e KV-së), 9 (vendime të KV-së për tituj pronësie të kundërligjshme) dhe 10 (procedurat për titujt e pronësisë të krijuar në kundërshtim me ligjin) të ligjit të kundërshtuar, që ngarkojnë KV-të, si dhe autoritetet e regjistrimit, me detyrën e anulimit të titujve të pronësisë të fituara sipas ligjeve përkatëse, si dhe të fshirjes së regjistrimeve të këtyre titujve në regjistrin e pronave të paluajtshme, duhet të shqyrtohet në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike.

Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se, me përfundimin e procedurave të përcaktuara në ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, ligjin nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, si dhe në ligjin nr.8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, me kalimin e afateve përkatëse të kundërshtimit, si dhe me regjistrimin e pronave përkatëse në regjistrin e pasurive të paluajtshme, përfituesit nga këto procedura, bëhen mbajtës të titujve të pronësisë, që mbrohen nga neni 41 i Kushtetutës. Për pasojë, midis këtyre individëve, me cilësinë e pronarëve të tokës bujqësore dhe gjithë subjekteve të tjera, duke përfshirë edhe shtetin, krijohet një marrëdhënie që trajtohet në kuadrin e së drejtës private. Kjo do të thotë se, pas këtij momenti që u përshkrua më sipër, çdo pretendim kundrejt pronarëve të mësipërm, zgjidhet në kuadrin e së drejtës private. Për pasojë, titujt e pronësisë të fituar si rezultat i përfundimit të procedurave të parashikuara në ligjet e sipërpërmendura, si dhe regjistrimet e këtyre titujve në regjistrat e pronave të paluajtshme, nuk mund të anulohen apo shfuqizohen *iure imperi*, pra në mënyrë të njëanshme, me anën e vendimeve administrative të nxjerra nga autoritetet publike përkatëse.

Gjykata Kushtetuese vë në dukje gjithashtu, se mbajtja e regjistrit publik të pronave të paluajtshme dhe të transferimeve të saj ka për qëllim sigurinë e të drejtave të pronës, si dhe stabilitetin e qarkullimit civil. Në vlerësimin e Gjykatës, pikërisht për këtë qëllim, regjistri publik i regjistrimit të pronave të paluajtshme duhet të jetë një regjistër i sigurt dhe i besueshëm. Roli i tij është i një rëndësie themelore, sepse nëpërmjet tij ngurtësohen të drejta subjektive. Mungesa e besueshmërisë në këtë drejtim passjell pasiguri në të drejtat e pronës. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese vlerëson se krijimi i një gjendjeje pasigurie juridike në këto regjistra nuk mund të korrigjohet me zgjidhje që imponojnë veprime po aq të pasigurta, siç është fshirja e regjistrimit që

mund të bëhet nga autoritetet e regjistrimit. Kthimi në ligjshmëri nuk mund të bëhet me mjete të njëanshme (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 23.04.2010*).

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese duhet të vlerësojë nëse dispozitat e kundërshtuara janë në pajtim me standardet kushtetuese të trajtuara më sipër.

Sipas nenit 8/2/3 të ligjit të kundërshtuar, në pjesët përkatëse që lidhen me çështjen në shqyrtim, KV-ja merr vendimet përkatëse për bazueshmërinë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, për korrigjimet e nevojshme, shfuqizimin e plotë apo të pjesshëm të këtij dokumentacioni dhe vendimi i KV-së i dërgohet për veprim ZVRPP-së së rrethit. Në të njëjtën kohë, sipas nenit 10/1 të këtij ligji, kur KV-ja, gjatë verifikimit, vëren se krijimi i titujve të pronësisë mbi tokën është bërë në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në nenet 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, i paraqet gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës një kërkesë për anulimin e aktit administrativ “akti i marrjes së tokës në pronësi”, dhe sipas pikës 2 të nenit 10 të këtij ligji, kërkesa i paraqitet subjektit përkatës nga prefekti dhe objekti i kërkesës së prefektit është deklarimi i pavlefshmërisë së “aktit të marrjes së tokës në pronësi”.

Gjykata vlerëson se, në rastin në shqyrtim, mund të aplikohet një interpretim pajtues i ligjit të kundërshtuar. Ky interpretim është i mundur kur një ligj apo dispozitë ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë, njëra nga të cilat është në pajtim me Kushtetutën. Kjo metodë kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve.

Duke bërë një interpretim sistematik të dispozitave të mësipërme të ligjit të kundërshtuar, nga konteksti i tyre, si dhe nisur nga kuptimi i përgjithshëm i këtij ligji, pra nisur nga *ratio legis* (ose qëllimi final social dhe ekonomik i normës), Gjykata vlerëson se qëllimi i tyre është t`i vendosin komisionet vendore në pozicionin e konstatuesit të situatës së paligjshmërisë, parregullsive të titujve të pronësisë, në drejtim të mangësive të tyre ligjore. Këto komisione mundën vetëm të ngrejshin dyshime në lidhje me fitimin e pronësisë dhe më pas duhet t`i drejtohen gjykatës, e cila do të vendosë në lidhje me vlefshmërinë ose jo të titullit të pronësisë dhe, në rast të konstatimit të kësaj pavlefshmërie, janë po gjykatat që do të vendosin edhe për pasojat ligjore. Kjo do të thotë se vendimet e marra nga komisionet vendore, në bazë të kompetencave që u japin dispozitat e kundërshtuara, nuk mund të sjellin si rezultat anulimin apo shfuqizimin e akteve që kanë krijuar tituj pronësie. Gjithashtu, këto vendime nuk mund të urdhërojnë zyrat e regjistrimit për fshirjen e regjistrimit të këtyre titujve. Verifikimet/konstatimet e KV-ve mund të shërbejnë vetëm si bazë për ngritjen e padisë në gjykatë nga subjektet përkatëse të interesuara apo nga shteti, nëpërmjet autoriteteve përkatëse.

Bazuar në këtë interpretim pajtues, Gjykata arrin në përfundimin se ligji i kundërshtuar është kushtetues, me kusht që dispozitat e tij të interpretohen si më sipër. Asnjë interpretim tjetër i këtyre dispozitave nuk është i lejueshëm nga pikëpamja kushtetuese dhe se mbrojtja e të drejtave të fituara nuk mund të arrihet në rast se dispozitat e kundërshtuara u jepet një kuptim tjetër.

Nisur nga interpretimi i mësipërm, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se ligji i kundërshtuar nuk cenon parimin e sigurisë juridike.

*2. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve (neni 7 i Kushtetutës)*

Pala kërkuese ka pretenduar gjithashtu se, ligji i kundërshtuar, duke iu dhënë kompetencë komisioneve vendore të zgjidhin konflikte në fushën e të drejtave të pronës, cenon edhe parimin e ndarjes së pushteteve.

Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese rithekson se parimi i ndarjes së pushteteve, i sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, do të thotë se sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve, çka nënkupton se ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe me një balancë ndërmjet tyre. Çdo institucion i një pushteti gëzon kompetenca sipas këtij qëllimi. Përmbajtja konkrete e këtyre kompetencave varet nga fakti se cilit pushtet i përket ky institucion, nga vendi i tij midis institucioneve të tjera, si dhe nga raportet e fuqive të tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me funksionet e ngarkuara nga Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me

pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit, do të përbënin *objektin qendror* të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.25, datë 05.12.2008*).

Për sa sipër, në kuadrin e pretendimit të ngritur nga pala kërkuese, se autoritetet e verifikimit cenojnë pushtetin gjyqësor, Gjykata Kushtetuese duhet të shqyrtojë nëse këto organe, në rastin në shqyrtim, janë veshur me pushtet gjyqësor. Sipas nenit 135/1 të Kushtetutës, *pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj*. Ndërsa sipas nenit 36/1/2 të Kodit të Procedurës Civile, *në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta ... dhe se, asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata*. Kjo do të thotë se, në aspektin kushtetues e ligjor, pushteti për dhënien e drejtësisë, domethënë pushteti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile u është dhënë gjykatave.

Në rastin në shqyrtim Gjykata Kushtetuese vlerëson, siç u konkludua në pikën 1 të këtij vendimi, se me përfundimin e procedurave të përcaktuara në ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, ligjin nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, si dhe në ligjin nr.8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, me kalimin e afateve përkatëse të kundërshtimit, si dhe me regjistrimin e pronave përkatëse në regjistrin e pasurive të paluajtshme, përfituesit nga këto procedura bëhen mbajtës të titujve të pronësisë, që mbrohen nga neni 41 i Kushtetutës. Për pasojë, midis këtyre individëve, me cilësinë e pronarëve të tokës bujqësore, dhe gjithë subjekteve të tjera, përfshirë këtu edhe shtetin, krijohet një marrëdhënie që trajtohet në kuadrin e së drejtës private. Pas këtij momenti, çdo pretendim kundrejt pronarëve të mësipërm, lidhur me të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore, përbën një mosmarrëveshje civile, zgjidhja e së cilës përbën juridiksion gjyqësor. Për pasojë, edhe verifikimi i titujve të pronësisë me rezultat anulimin, shfuqizimin apo lënien në fuqi të tyre përbën juridiksion gjyqësor. Në këto rrethana çështja që shtrohet është nëse ligji i kundërshtuar i ka veshur KV-të me pushtet gjyqësor, gjë që do të cenonte parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve.

Në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese vëren se ligji nr. 9948 nuk i ka veshur komisionet vendore me funksion gjyqësor. Kështu, duke pasur parasysh interpretimin pajtues të bërë nga kjo Gjykatë në pikën 1 të këtij vendimi, komisionet vendore, në bazë të ligjit të mësipërm, kanë vetëm kompetencën e konstatimit të parregullsive, por jo atë të anulimit apo shfuqizimit të akteve administrative që janë burimi i titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, apo të çregjistrimit të këtyre titujve nga regjistri i pasurive së paluajtshme. Me anën e këtij verifikimi, KV-të nuk zgjidhin mosmarrëveshje për titullin e pronësisë mbi tokën bujqësore. Të dhënat e verifikimit shërbejnë vetëm si bazë për ngritjen e padisë në gjykatë, e cila ka juridiksion për të deklaruar përfundimisht se kujt i takon e drejta e pronësisë mbi tokën bujqësore.

Për sa sipër, Gjykata Kushtetuese konkludon se ligji i kundërshtuar nuk cenon parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve.

### *3. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës private (neni 41 i Kushtetutës)*

Pala kërkuese ka pretenduar gjithashtu se ligji nr. 9948 cenon të drejtën e pronës, në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së, sepse askush nuk mund të shpronësohet ose t'i kufizohet e drejta e ushtrimit të së drejtës së pronës që barazohet me shpronësimin, përveçse kur këtë e kërkojnë interesat publikë dhe kurdoherë kundrejt një shpërblimi të plotë dhe paraprak; ka shumë subjekte që gjatë viteve 1993-2009 kanë fituar pronësinë e tokës bujqësore me vendime gjyqësore të formës së prerë, të cilat mund të shfuqizohen për efekt të zbatimit të këtij ligji.

Gjykata thekson se neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës private, si dhe përcakton kritere për shpronësimin apo kufizimin me ligj në ushtrimin e kësaj të drejte. Po ashtu, neni 1 i Protokollit nr.1 të KEDNJ-së garanton në substancë të drejtën e pronës. Ky nen mbron gëzimin e qetë të pronës, vendos kushte për privimin nga pasuria, si dhe u njeh shteteve të drejtën, mes të tjerash, të kontrollojnë përdorimin e pasurive në pajtim me interesin e përgjithshëm.

Gjykata Kushtetuese thekson se ligji nr. 9948 nuk cenon të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore, të fituar në mënyrë të ligjshme, bazuar në kriteret e vendosura nga legjislacioni në fuqi.

Siç është pranuar edhe në pikën 1 të këtij vendimi, ligji i kundërshtuar nuk i ngarkon KV-të apo organet e regjistrimit të anulojnë apo shfuqizojnë titujt e pronësisë apo t'i çregjistrojnë këto tituj nga regjistrat e pasurive të paluajtshme. Verifikimi që kryejnë KV-të, në bazë të këtij ligji, ka karakter konstatues dhe nuk ka si rezultat të drejtpërdrejtë anulimin apo shfuqizimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, si dhe çregjistrimin e tyre nga regjistrat përkatës. Siç është përmendur edhe më sipër në këtë vendim, të dhënat e këtij verifikimi mund të shërbejnë vetëm si bazë për ngritjen e padisë në gjykatë.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese konkludon se ligji i kundërshtuar është në pajtim me nenin 41 të Kushtetutës.

*4. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës.*

Pala kërkuese ka pretenduar gjithashtu se ligji nr. 9948 cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, sepse nuk u njeh pronarëve të tokës bujqësore të drejtën t'i drejtohen gjykatës.

Në përgjigje të këtij pretendimi, Gjykata Kushtetuese rithekson se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Kjo e drejtë kushtetuese ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 4.04.2007*). E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit), nënkupton të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 11.05.1006*). Gjykata shton gjithashtu se e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vetvete, nënkupton edhe detyrimin e shtetit për t'i garantuar personit aksesin në gjykatë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 6.03.2009*).

Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se ligji i kundërshtuar nuk vendos ndonjë pengesë që personat e cenuar t'i drejtohen gjykatës. Fakti që ligji ka parashikuar komisionet vendore si organe kompetente për verifikimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, por pa i anuluar apo shfuqizuar këto tituj, si dhe pa urdhëruar çregjistrimin e këtyre titujve nga regjistri i pasurive të paluajtshme, nuk do të thotë se ai ua mohon subjekteve përkatëse këtë të drejtë.

Sa sipër, Gjykata Kushtetuese thekson se ligji nr.9948, datë 7.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, është në pajtim me Kushtetutën vetëm nëse ai interpretohet dhe zbatohet në përputhje me parimet e theksuara prej kësaj Gjykate, pra ai nuk prek titujt e pronësisë të dhënë në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në kohën e krijimit të tyre, komisionet vendore janë vetëm konstatuese të pavlefshmërisë, këto komisione nuk mund të anulojnë apo shfuqizojnë titujt e pronësisë, apo të urdhërojnë çregjistrimin e këtyre titujve nga regjistri i pasurive të paluajtshme. Është vetëm gjykata, e cila mbi padinë e të interesuarve apo autoriteteve publike përkatëse, vendos përfundimisht në lidhje me të drejtën e pronësisë së subjekteve të interesuara.

Gjykata thekson gjithashtu se argumentet e mësipërme në lidhje me ligjin nr. 9948, vlejnë edhe për pretendimet për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, germa “a”, dhe 134, pika 1, germa “dh” të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

## VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Petrit Pllloçi, Admir Thanza  
Anëtarë kundër: Sokol Sadushi, Sokol Berberi

## VENDIM Nr. 30, datë 17.6.2010

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese		
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Pllloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 26.01.2010 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh çështjen nr.30/18 Akti, që i përket:

**KËRKUES: GJYKATA E LARTË (KOLEGJET E BASHKUARA)**

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, përfaqësuar nga z.Lulzim Lelçaj, me autorizim.

**KËSHILLI I MINISTRAVE**, përfaqësuar nga znj.Marsida Xhaferllari, me autorizim.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**, përfaqësuar nga z.Artur Selmani, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i nenit 48, paragrafi i tretë dhe i nenit 410, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale si të papajtueshëm me nenin 43 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:**Nenet 145/2 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Fehmi Abdiu, pasi shqyrtoi çështjen mbi aktet dhe diskutoi për të në tërësi,

### VËREN:

#### I

1.0 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 302, datë 11.12.2002, ka deklaruar fajtor dhe dënuar të pandehurin E.S. për kryerjen e veprave penale të marrëdhënieve seksuale me të mitura dhe të favorizimit të prostitucionit me të mitura, të parashikuara nga nenet 100/1 dhe 114/2 të Kodit Penal.



2. Mbi ankimin e paraqitur nga avokati i caktuar kryesisht i këtij të pandehuri, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 82, datë 4.04.2003, ka vendosur mospranimin e apelit, pasi ankimi është bërë nga një subjekt që nuk legjitimohet.

3. Më pas, mbi kërkesën e bërë nga avokati i caktuar me prokurë të posaçme nga babai i të pandehurit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 22, datë 20.04.2004, ka vendosur rivendosjen në afat për të bërë ankim kërkuesi E.S. kundër vendimit nr. 302, datë 11.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me paraqitjen e ankimit nga avokati i caktuar nga familjarët e të pandehurit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 585, datë 10.12.2004, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 302, datë 11.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

4. Mbi rekursin e paraqitur nga i njëjti avokat, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 872, datë 16.12.2005, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga mbrojtësi i të gjykuarit E.S. kundër vendimit nr. 585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

5. Mbi kërkesën e të gjykuarit, i cili pasi është ekstraduar ka pretenduar se nuk ka pasur dijeni për vendimet e gjykatave që e kanë deklaruar fajtor dhe dënuar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.128, datë 13.04.2007, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit E.Spahaj dhe rivendosjen në afat të së drejtës për të bërë recurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

6. Kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë ka paraqitur recurs i gjykuari E.S. nëpërmjet avokatit të autorizuar prej tij me prokurë të posaçme.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin ekstra, datë 9.04.2008, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njehsimin e praktikës gjyqësore lidhur me këto probleme juridike:

- Pasi çështja është shqyrtuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, a ka të drejtë i pandehuri apo mbrojtësi i tij të rivendosen në afat për të ushtruar recurs ndaj të njëjtit vendim të Gjykatës së Apelit, nëse i pandehuri pretendon se nuk është vënë në dijeni të vendimit? E njëjta pyetje shtrohet edhe në rastin kur i pandehuri pretendon të rivendoset në afat për të drejtën e apelit.

- Nëse gjykata më e lartë vendos mospranimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës më të ulët për shkak të kalimit të afatit, a mund të kërkohet rivendosje në afat për të ushtruar ankim ndaj të njëjtit vendim?

- Në rastin e më shumë se një të pandehuri, kur çështja shqyrtohet mbi bazën e ankimit të një pjese të tyre, të pandehurit që nuk kanë ushtruar të drejtën e ankimit, a u lind kjo e drejtë pasi vihen në dijeni të vendimit, nëse gjykata më e lartë në përfundim është shprehur për të gjithë të pandehurit bashkë?

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë gjykimit të çështjes për vendimin nr.3/2, datë 9.01.2009, kanë vendosur pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes para Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur për pajtueshmërinë e neneve 48/3 dhe 410/2 të Kodit të Procedurës Penale (KPr.P) me nenin 43 të Kushtetutës.

8. **Kërkuesi** ka parashtruar këto shkaqe në mbështetje të kërkesës:

8.1 Paraqitja e rekursit nga i gjykuari, pas rivendosjes në afat, është një e drejtë kushtetuese e sanksionuar nga neni 43 i Kushtetutës.

8.2 Caktimi i përfaqësuesit ligjor me prokurë të posaçme nga familjarët e të gjykuarit nuk mund të konsiderohet sikur është konsumuar e drejta e ankimit nga i pandehuri/i dënuari, sepse kjo e drejtë i përket tërësisht atij.

9. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, ka parashtruar këto shkaqe:

9.1 Gjykata e Lartë nuk legjitimohet për shkak të mungesës së kritereve të legjitimitimit konform nenit 145/2 të Kushtetutës.

9.2 Realizimi i mbrojtjes së të pandehurit ose të dënuarit me anë të mbrojtësit të caktuar nga familjarët e tij vjen në përputhje me parimet kushtetuese dhe konkretisht me nenin 17 dhe 42 të Kushtetutës.

9.3 Në qoftë se do të konsiderohej se përfaqësimi i të pandehurit apo të dënuarit me një mbrojtës të zgjedhur nga familja e tij është antikushtetuese, do të krijohej një situatë kaotike, sepse organi procedues nuk do të kryente asnjë veprim procedural pa marrjen dijeni personalisht të të pandehurit.

9.4 E drejta e ankimit ndaj vendimit të gjykatës nuk është një e drejtë tërësore që i takon vetëm të pandehurit siç është e drejta për të mos pranuar veprën penale, e drejta për të mos bërë deklarime etj. Ajo i takon edhe mbrojtësit si një ndër kushtet për realizimin e plotë të mbrojtjes.

10. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, ka parashtruar këto shkaqe:

10.1. Neni 48/3 i KPr.P është në përputhje me nenin 43 të Kushtetutës.

10.2. Neni 48/3 i KPr.P është në fakt një detajim ligjor i nenit 31 të Kushtetutës, sepse me anë të tij një personi i jepet mundësia të ketë lehtësi të mjaftueshme, për të përgatitur mbrojtjen e vet dhe të ketë ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur.

11. **Subjekti i interesuar, Prokurori i Përgjithshëm**, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, ka parashtruar këto shkaqe:

11.1 Çështja e kushtetutshmërisë së neneve 48/3 dhe 410 të KPr.P, përsa i përket mundësisë së avokatit për të ushtruar në emër dhe për llogari të të pandehurit të drejtën e tij për t'u ankuar, përbën gjë të gjykuar, me vendimin nr.5, datë 7.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese.

11.2 Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë për t'u shprehur lidhur me antikushtetutshmërinë e vetë dispozitave të Kushtetutës dhe të interpretimeve kushtetuese të bëra nga vetë ajo. Sipas Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, interpretimi kushtetues i bërë nga Gjykata Kushtetuese për nenin 48/3 dhe 410/2 të KPr.P me vendimet nr.17, datë 17.04.2000 dhe nr.5, datë 7.02.2001 bie ndesh me vetë Kushtetutën, konkretisht me nenin 43 të saj.

## II

### A. Lidhur me legjitimitimin

12. Neni 145, pika 2 e Kushtetutës u njej të drejtën gjyqtarëve, që në çdo fazë të gjykimit, kur ata çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato. Sipas nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, gjyqtari ose gjykata gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit.

13. Gjykata Kushtetuese është shprehur gjatë jurisprudences së saj se “Gjykata, veç çmimit se pse ligji është antikushtetues, duhet të sqarojë me kujdes dhe *lidhjen e drejtpërdrejtë* midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete që, sipas kuptimit të nenit 68 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, evidentimi i një lidhjeje të tillë është i domosdoshëm” (*Vendimi nr. 5, datë 6.03.2009 i Gjykatës Kushtetuese*).

14. Duke insistuar në këtë kërkesë, kjo Gjykatë në një vendim tjetër është shprehur se, “...Para marrjes së vendimit të pezullimit gjyqtari apo gjykata duhet të kenë parasysh që gjykimi që ata kanë nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Pra gjyqtari duhet të krijojë mendimin se ligji që ai vlerëson si antikushtetues do të zbatohet për zgjidhjen e

çështjes. Në të kundërt nëse gjyqtari vlerëson se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e tij për zgjidhjen e çështjes edhe pse sipas tij, është antikushtetues, duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes. Në mënyrë që të ekzistojë lidhje e drejtpërdrejtë duhet të ketë një raport të domosdoshëm mes vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga kjo Gjykatë) dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga gjyqtari apo gjykata, subjekt iniciues i gjykimit incidental, në kuptimin që gjykimi nga gjykata e zakonshme nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese” (*Vendimi nr.13, datë 4.05.2009 i Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për rastin në shqyrtim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë parashtruar se përfundimi i shqyrtimit të çështjes vështirësohet ose bëhet i pamundur pa u verifikuar kushtetutshmëria e dispozitave që përbëjnë objektin e shqyrtimit kushtetues.

16. Veç sa më lart, Gjykata Kushtetuese vëren se rreth problematikës dhe pretendimeve të parashtruara në praktikën gjyqësore janë vënë re dykuptimësi që i dëmtojnë interesat e drejtësisë. Duke qenë kështu, Gjykata vlerësoi se në rastin konkret ekzistojnë kushtet e nevojshme për legjitimitimin e Gjykatës referuese.

### III

#### ***B. Lidhur me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese për të drejtën e ankimit të të gjykuarit në mungesë***

Për sa i përket gjykimit në mungesë dhe të drejtës së ankimit kundër vendimeve të tilla, jurisprudenca e drejtësisë kushtetuese ka evoluar në mënyrë periodike.

17. Neni 33 i Kushtetutës përcakton se “Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë”. Në nenin 43 të Kushtetutës përcaktohet se “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”. Këto trajtesa parimore kushtetuese kanë gjetur detajimin e tyre në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

18. Në nenin 48/3 të KPr.P parashikohet përkatësisht: “*Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara nga paragrafi 2*”.... Po ashtu neni 410, paragrafi i dytë përcakton se “*Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji.*

19. Gjykata Kushtetuese ndër vite e ka trajtuar gjykimin në mungesë të të pandehurit si një aspekt shumë të rëndësishëm të një procesi të rregullt ligjor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

20. Me vendimin nr.17, datë 17.04.2000 Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar vendimin nr.386, datë 29.07.1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë si antikushtetues, duke arsyetuar se i është mohuar kërkesit e drejta e mbrojtjes në procesin penal, duke zhvilluar një proces gjyqësor të parregullt. Me vendimin e tyre, Kolegjet e Bashkuara kanë arsyetuar se zbatimi i së drejtës së ankimit nga mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurve, mohon të drejtën e këtyre të fundit, për të ushtruar ose jo ankim ndaj vendimit të gjykatës, sepse mbrojtësi nuk është zgjedhur ose pranuar nga vetë të pandehurit. Ndryshe nga sa kanë pranuar Kolegjet e Bashkuara, sipas Gjykatës Kushtetuese një arsyetim i tillë është i pabazuar, sepse konfondon të drejtën e ankimit me të drejtën për të kërkuar rivendosjen e afatit të humbur për të bërë ankim dhe, nga ana tjetër, është kontradiktor dhe alogjik, sepse pranon të drejtën e ankimit, por nuk përcakton zgjidhjen praktike dhe ligjore të saj. I pandehuri, që gjykohet në mungesë, nuk realizon dot vetë as të drejtën e ankimit dhe as atë të rivendosjes në afat, prandaj ligji, në zbatim të parimit kushtetues, ngarkon me këtë detyrë dhe njëkohësisht i jep të drejtë mbrojtësit të caktuar në një nga format e parashikuara në ligj. Vendimi i lartpërmendur sipas Gjykatës Kushtetuese është rrjedhojë e një procesi të parregullt

edhe për një shkak tjetër: nga njëra anë pranohet për shqyrtim rekursi i prokurorit kundër vendimit të pafajësisë dhe, nga ana tjetër, duke vendosur moslegjitimitimin e mbrojtësit të caktuar nga familjarët, i vë palët në pozita të pabarabarta.

21. Me vendimin *nr.5, datë 7.02.2001* Gjykata Kushtetuese, duke bërë një interpretim përfundimtar të ligjit lidhur me të drejtën e mbrojtjes në frymën e Kushtetutës dhe të akteve ndërkombëtare, është shprehur se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme. Ato përbëjnë jurisprudencën kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e formës së prerë. Për të drejtën e mbrojtësit, të caktuar nga të afërmit e të pandehurit, për të bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës sipas neneve 48 dhe 410/2 të KPr.P, kjo Gjykatë ka rikonfirmuar qëndrimin e saj të mëparshëm nëpërmjet interpretimit kushtetues.

22. Me vendimin *nr.15, datë 17.04.2003* Gjykata Kushtetuese është shprehur për kushtetutshmërinë e nenit 410/2 të KPr.P. Në këtë nen përcaktohet se “Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar nga *i pandehuri*, në format e parashikuara nga ligji.” Gjykata ka shfuqizuar fjalën “i pandehuri” nga dispozita në fjalë. Ajo ka theksuar se “...shtesa “i pandehuri” në vetvete rezulton e panevojshme, sepse pa të ky paragraf (prg.2) është i kuptueshëm dhe i zbatueshëm në lidhje dhe me dispozita të tjera të ligjit. ... Përmbajtja e nenit 410/2 ka si qëllim të njohë dhe garantojë të drejtën e ankimit ndaj vendimit gjyqësor të dhënë në mungesë të të akuzuarit...Kufizimi i bërë në nenin 410/2 nuk përmbush asnjë nga këto kërkesa të rëndësishme, por bie haptazi në kundërshtim me to....Moslejimi i mbrojtësit për të bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës të dhënë në mungesë të të akuzuarit në kushtet e nenit 410/2 të KPr.Penale e vë njërin palë në pozitë të pabarabartë me palën tjetër.”

23. Po në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese shprehet se “... Nga ana tjetër për t’i qëndruar konsekuent ndryshimit të bërë në paragrafin e dytë të nenit 410 të KPr.Penale, organi ligjvënës duhej të harmonizonte me të dhe pikën 3 të nenit 48 të këtij Kodi, sipas së cilës, zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij në format e parashikuara në paragrafin e dytë të këtij neni. Po të bëhet krahasimi i përmbajtjes së këtyre neneve të të njëjtit ligj, del se sipas nenit 48, mbrojtësi mund të caktohet jo vetëm nga i pandehuri, por edhe nga të afërmit e tij, por për të bërë ankim ndaj vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit, sipas nenit 410/2 kërkohet akti i përfaqësimit i lëshuar nga ky i fundit. Caktimi i mbrojtësit në procesin penal në kushtet dhe mënyrat e parashikuara në ligj, përfshirë dhe atë të caktuar kryesisht nga gjykata, nuk ka për qëllim vetëm pjesëmarrjen e tij në një shkallë të gjyqimit, por ndjekjen e çështjes nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së ankimit dhe pjesëmarrjes në të, deri në instancën më të lartë gjyqësore, për të mbrojtur plotësisht të drejtat e të pandehurit në një proces të rregullt ligjor. Duke pasur caktimi i mbrojtësit këtë qëllim ligjor e kushtetues, del se përmbajtja e nenit 410/2 vjen ndesh me të e për rrjedhojë ka karakter antikushtetues.”

24. Sa më lart, Gjykata Kushtetuese me këtë praktikë ka analizuar nenin 410/2 të KPr.P në këtë çështje, duke ndjekur linjën e arsyetimit se fjala “i pandehuri” në paragrafin e dytë të nenit 410 të KPr.P është antikushtetues, sepse bie ndesh me nenin 31/c dhe 43 të Kushtetutës, si dhe me nenet 6 dhe 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, më konkretisht me të drejtën e ankimit, të mbrojtjes për vetë të pandehurin, si dhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, si elemente të procesit të rregullt ligjor.

### ***C. Lidhur me jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut për të drejtën e ankimit të të gjykuarit në mungesë***

25. Sipas nenit 2, protokollit 7 të KEDNJ-së: 1. Çdo person i deklaruar fajtor për një veprë penale nga një gjykatë ka të drejtën të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimit. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, është i përcaktuar me ligj. 2. Nga kjo e drejtë mund të ketë

përrjashtime për vepra të lehta, siç janë përcaktuar nga ligji, ose kur i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, ose është deklaruar fajtor dhe dënuar në vijim të një kundërshtimi kundër pafajësisë së tij.

26. Gjykata Kushtetuese vlerëson standardet e vendosura nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ) që theksojnë: a) i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm në procesin gjyqësor të kryer në ngarkim të tij; b) i pandehuri mund të heqë dorë vullnetarisht nga ushtrimi i kësaj të drejtë; c) i pandehuri duhet të jetë në dijeni për ekzistencën e një procesi gjyqësor në ngarkim të tij; ç) duhet të ekzistojnë instrumente paraprake ose riparuese për të shmangur procese në ngarkim të tij, ose për të siguruar një proces të ri dhe, nëpërmjet depozitimit të provave të reja, të drejtën e mbrojtjes që nuk ka qenë e mundur ta ushtrojë personalisht në procesin në mungesë të përfunduar tashmë.

27. Veç këtyre, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ka miratuar Rezolutën (75) 11 “Për kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit”, duke u rekomanduar shteteve anëtare që të mbajnë parasysh 9 rregulla minimale: i) Askush nuk duhet të gjykohet pa pasur një thirrje për gjyq në kohë. ii) Kjo thirrje për gjyq duhet të ketë të sanksionuara edhe pasojat nëse i akuzuari nuk vjen në gjykim. iii) Kur gjykata vëren se edhe pse i akuzuari është njoftuar dhe nuk është paraqitur, ajo, nëse çmon se prania e tij në proces është e pazëvendësueshme ose beson se i akuzuari është penguar të paraqitet, duhet të vendosë shtyrjen e procesit. iv) I akuzuari nuk duhet të gjykohet në mungesë, nëse është e mundur të transferohen procedimet te një shtet tjetër ose të aplikohet për ekstradim. v) Kur i akuzuari gjykohet në mungesë, provat duhet të merren në mënyrë të zakonshme dhe mbrojtja duhet të ketë të drejtë të ndërhyjë. vi) Një vendim gjykate i dhënë në mungesë duhet t’i njoftohet personit sipas rregullave për njoftimet dhe marrjes dijeni brenda afatit të parashikuar për apelim. Ky afat duhet të fillojë që nga dita e marrjes dijeni efektivisht të personit, përveçse kur ai qëllimisht i fshihet drejtësisë. vii) Çdo personi të gjykuar në mungesë duhet t’i jepet e drejta për apelim me çdo lloj mjeti ligjor, që do t’i ishte dhënë sikur ai të ishte i pranishëm. viii) Për personin e gjykuar në mungesë, të cilit nuk i është bërë njoftimi në mënyrën e duhur, duhet të ketë një mjet ankimi që t’i mundësojë atij shfuqizimin e vendimit. ix) Një person i gjykuar në mungesë, por që njoftimi i është bërë në rregull, duhet të ketë të drejtën e një rigjykimi në mënyrën e zakonshme, nëse ai mund të provojë mungesën e tij para gjykatës për arsye të pavarura nga vullneti i tij.

28. Duke u bazuar në këto qëndrime, GjEDNJ, duke pasuruar praktikën e saj, ka vendosur shumë detyra për drejtësinë kushtetuese lidhur me gjykimin në mungesë. Ajo ka theksuar se e drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë. (*Ektabani kundër Suedisë 1988 Vaundelle kundër Francës 2003*). Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. (*T and V kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur procedimet kanë natyrë kontradiktore. Shteti ka detyrimin për t’i dhënë të pandehurit një njoftim efektiv dhe të përshtatshëm për seancën dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij (*Poitrimol kundër Francës 1993, Spinatto kundër HMP Brixton dhe Italisë 2001*). GjEDNJ thekson se është e një rëndësie thelbësore, që i akuzuari duhet të jetë i pranishëm në seancë, sepse ai ka të drejtën të dëgjohet, por edhe sepse ai ka nevojë t’i verifikojë gjykatës vërtetësinë e thënieve të tij dhe t’i krahasojë këto me të palës tjetër ose dhe të dëshmitarëve. Ligjvënësi duhet të jetë në gjendje të mos nxisë mungesa të pajustificueshme (*Geyseghem kundër Belgjikës 1999*). Edhe pse nuk është absolute, e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t’u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, është një nga kriteret kryesore të gjykimit të drejtë. Një person i akuzuar penalisht nuk e humb këtë të drejtë thjesht për faktin se ai nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq. (*Mariani kundër Francës, 2005*).

29. GjEDNJ është shprehur se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. Njoftimi i paqartë dhe joformal nuk mjaftojnë. Nëse mund të pranohet një njoftim edhe tërthorazi, heqja dorë duhet të jetë e qartë. Është një e drejtë e personit të dënuar *in absentia*, i cili nuk rezulton se ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykim, të ketë në të gjitha rastet një vendim të ri mbi akuzat. (*Sejdovic kundër Italisë 2000*).

30. Konventa u lë shteteve kontraktuese një diskrecion të gjerë lidhur me zgjedhjet e mjeteve, për të siguruar se sistemi i tyre ligjor është në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Konventës. Detyra e GjEDNJ-së është të shqyrtojë nëse rezultati që Konventa kërkon është arritur nga shtetet kontraktuese. Veçanërisht mjetet procedurale të ofruara nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se kanë qenë efektive, kur një person i akuzuar penalisht as nuk ka hequr dorë nga të drejtat e tij për t'u dëgjuar dhe mbrojtur personalisht dhe as nuk i është fshehur drejtësisë. Mospranimi, për të rihapur procedurat e zhvilluara në mungesë të të akuzuarit, pa asnjë të dhënë se i akuzuari ka hequr dorë nga të drejtat e tij për të qenë i pranishëm, konsiderohet “një shkelje flagrante dhe mohim i drejtësisë”. Rihapja e çështjes brenda afateve ligjore, kundër një vendimi të dhënë në mungesë, kur mbrojtësi e kishte autoritetin për të kërkuar pranimin e provave të reja, e bëjnë të detyrueshëm ndryshimin e vendimit dhe të akuzave, në atë mënyrë që procedimet në tërësi do të konsiderohen të drejta (*Stoichkov kundër Bullgarisë*). As një shkronjë, por as dhe shpirti i nenit 6 të Konventës nuk e ndalojnë një person të heqë dorë nga të drejtat e tij, me dëshirë shprehimisht ose taktikisht. Por megjithatë për qëllimet e Konventës do të konsiderohet efektive, që të drejtat e atij, që ka hequr dorë prej tyre, të sanksionohen pa ekuivoqe dhe të shoqërohen me një minimum të garancive, për shkak të rëndësisë së tyre.

31. GjEDNJ në një rast tjetër ka vërejtur se kërkuesi, pas marrjes së vendimit nga gjykata e faktit në favor të tij, dështoi në detyrimin për të informuar autoritetet për ndryshimin e adresës së tij, siç e kërkonte ligji kombëtar italian. Autoritetet u munduan që ta vënë në dijeni për të gjitha aktet, në adresën që ai kishte lënë në dispozicion. Me gjithë këto përpjekje për vënien në dijeni të të akuzuarit për akuzat e ngritura nga prokurori në Gjykatën e Apelit, ai nuk kishte dijeni për proceset gjyqësore kundër tij. Ai mori dijeni për dënimin e tij ditën e arrestimit. GjEDNJ rithekson se e drejta për t'iu drejtuar një gjykate, e cila në një aspekt të saj përfshin të drejtën e eksedit, nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve, veçanërisht lidhur me kushtet e pranimit të një apelimi. Gjithsesi këto kufizime nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e së drejtës. Këto duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura duhet të jenë përpjesëtimore me qëllimin që kërkohet të arrihet. Rregullat për mbarimin e afateve janë parashikuar për të siguruar administrimin e drejtësisë në përputhje veçanërisht me parimin e sigurisë juridike. Gjithsesi rregullat në diskutim, nuk duhet të bëhen pengesë që palët ndërgjyqëse të mos arrijnë të përdorin çdo lloj mjeti ankimi efektiv. (*Osu kundër Italisë 2002*).

32. Duke këmbëngulur në këtë kërkesë, GjEDNJ është shprehur se ajo e kishte për detyrë të ekzaminonte nëse ishin përmbushur kriteret e përcaktuara nga neni 6/3, ku thuhet se “... çdokush ka të drejtë të dëgjohet ...”. Pyetja që shtrohet para kësaj Gjykate është: Një procedurë e kombinuar, për të njoftuar një person i cili nuk ka adresë dhe procedura, për të pasur një gjykim në mungesë, a e garanton të drejtën e tij për t'u dëgjuar? Megjithëse nuk është e shprehur në paragrafin 1 të nenit 6, objekti dhe qëllimi i këtij neni të marra së bashku tregojnë se një person “i akuzuar penalisht” është i detyruar të marrë pjesë në seancë dëgjimore. Për më tepër, nënparagrafi (c), (d) dhe (e) e paragrafit 3 (neni 6-3-c, neni 6-3-d, neni 6-3-e) i garantojnë “secilit të akuzuar” të drejtën “të mbrojtë vetë veten e tij”, “të pyesë

dëshmitarë” dhe “t’i sigurohet përkthyes falas”. Është e vështirë të kuptosh se si këto të drejta mund të realizohen dhe se si mund t’i ushtrjë i akuzuari pa qenë vetë i pranishëm në seancë”.

33. Në rastin konkret Gjykatës Kushtetuese nuk i duhet të vendosë si dhe në çfarë kushtesh një i akuzuar mund të humbë të drejtën e tij për të qenë i pranishëm në seancë, përderisa për çdo rast, sipas jurisprudencës së GjEDNJ-së, heqja dorë nga ushtrimi i së drejtës së garantuar nga Konventa duhet të përcaktohet saktësisht. Megjithatë, në rrethanat e çështjes, faktet nuk justifikojnë humbjen e së drejtës për të marrë vetë pjesë në gjykim personalisht. Kur ligjet kombëtare lejojnë realizimin e gjykimeve në mungesë për një person “të akuzuar penalisht”, menjëherë, sapo ai merr dijeni për këtë proces, duhet të ketë mundësinë e së drejtës për t’u dëgjuar nga gjykata për një vendim të freskët mbi pretendimet e akuzës. Autoritetet kombëtare kanë një marzh vlerësimi për zgjedhjen e mjeteve në sistemet e tyre ligjore, por me kusht që këto mjete juridike të jenë në përputhje me standardet e vendosura nga neni 6/1 i Konventës (*Colozza kundër Italisë, 1985*).

34. Sa më lart, sipas praktikës së GjEDNJ-së, është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve sipas kësaj Gjykate, për të dyja rastet është detyrë e organeve kompetente. Dispozitat procedurale për njoftimet vendosin një rend të caktuar për mënyrën e njoftimit të akteve për të pandehurin, prandaj duhet respektuar rendi sipas preferencës ligjore për këtë qëllim. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin.

#### ***Ç. Lidhur me pajtueshmërinë e nenit 48/3 dhe 410/2 të Kodit të Procedurës Penale me nenin 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë***

35. Parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në Kushtetutë nënkupton rregullin e vazhdimësisë së jurisprudencës. Megjithatë është e pranueshme që jurisprudenca kushtetuese të evoluojë, duke synuar rritjen e standardeve kushtetuese. Pra, çdo ndryshim i precedentëve të Gjykatës Kushtetuese ose korrigjimi i doktrinës zyrtare kushtetuese mund të bëhet vetëm për arsye të rëndësishme, sidomos për ta harmonizuar atë me praktikën e GjEDNJ-së.

Nevoja për të riinterpretuar disa formulime të doktrinës kushtetuese mund të lindë edhe në funksion të zgjerimit të hapësirave, në përputhje me konceptet kushtetuese dhe të Konventës Europiane.

36. Në aspektin kushtetues është e palejueshme dhe e pamundur që doktrina kushtetuese zyrtare të interpretohet ose të riinterpretohet në një mënyrë të tillë që të ndryshojë sistemin e vlerave të sanksionuara në Kushtetutë, që të mohojë pajtueshmërinë e tyre, që të reduktojë garancitë mbrojtëse të epërsisë së saj në sistemin juridik, që të mohojë konceptimin e kushtetutës si një akt i vetëm dhe harmonik, që të reduktojë garancitë e të drejtave dhe lirive të individit të sanksionuara në kushtetutë dhe që të ndryshojë modelin e ndarjes së pushteteve (*vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë datë 28 mars 2006*).

37. Thënë sa më lart, Gjykata vlerëson se duhet të riinterpretojë praktikën e saj në lidhje me gjykimin në mungesë dhe sidomos në lidhje me të drejtën e të gjykuarit në mungesë, për t’u rivendosur në afat për të ankimuar vendimin e dhënë. Këtë mision gjykata e vlerëson se mund ta bëjë nëpërmjet interpretimit pajtues të dispozitave konkrete objekt shqyrtimi me Kushtetutën dhe me praktikën e Gjykatës Europiane, e cila ka vendosur disa detyrime rreth problematikës që ka të bëjë me gjykimin në mungesë.

38. Gjykata Kushtetuese e çmon me vend, që në përputhje me nenin 124 të Kushtetutës të bëjë një interpretim të nenit 33 të Kushtetutës, si edhe të pajtueshmërisë me të të neneve të KPr.P, për të cilat gjykata referuese ka paraqitur ankim me këtë dispozitë.

Pika 2 e nenit 33 të Kushtetutës përcakton se personat që i fshihen drejtësisë humbasin të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata. Në këtë kuptim Kushtetuta ka bërë një zgjedhje që ligjëron gjykimin e të pandehurit në mungesë kur plotësohen disa kushte, për të cilat në jurisprudencën e kësaj Gjykate dhe në praktikën gjyqësore kanë ekzistuar interpretime e qëndrime relativisht të ndryshme. Edhe për këtë arsye Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme që, për të siguruar standardet kushtetuese, duhet reflektuar duke u bazuar edhe në praktikën e GJEDNJ-së. Në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri duhet ketë dijeni nëse ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ky duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të. Gjykata arrin në këtë përfundim, për arsye se heqja dorë nënkupton një akt vullneti nga ana e të pandehurit, që siç është pranuar nga teoria e së drejtës penale, për të pasur një akt vullnetar duhet të ketë në radhë të parë një proces të brendshëm të perceptimit të realitetit nga ana e të pandehurit dhe më pas një proces të brendshëm vendimmarrjeje prej tij. Gjykata vlerëson se në të njëjtën mënyrë në këtë aspekt duhet kuptuar dhe përmbajtja e nenit 147/2 të KPr.P, në të cilin thuhet: “Në qoftë se është dhënë vendimi në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim, kur provon se nuk ka pasur dijeni për vendimin.”

39. Të njëjtin qëndrim si më sipër ka mbajtur edhe GJEDNJ-ja në çështjen *Somogyi kundër Italisë*, pasi ka arsyetuar se mungesa e të pandehurit në një gjykim në ngarkim të tij nuk është në vetvete një dhunim i nenit 6 të KEDNJ-së, duke u shprehur “se jemi para një mohimi të drejtësisë, kur një person i gjykuar në mungesë, nuk mund të arrijë që një gjykatë tjetër të shprehet përsëri në lidhje me akuzën, qoftë për sa i përket faktit, qoftë për sa i përket ligjshmërisë, pasi ta ketë dëgjuar, kur nuk përcaktohet në mënyrë të saktë që i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta që të paraqitet para gjykatës dhe të mbrohet ose që ka pasur qëllimin që t'i fshihet drejtësisë ...”. Rreth këtij problemi, në të njëjtin vendim, GJEDNJ-ja është shprehur se “... njoftimi i të akuzuarit në lidhje me akuzat në ngarkim të tij përbën një akt të një rëndësie të tillë, ku duhet të ekzistojnë elemente të formës dhe përmbajtjes që të garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtjes nga i akuzuari ... për rrjedhojë një njohuri e pasaktë dhe e marrë nga burime jozyrtare nuk është e mjaftueshme.”

40. Gjykata Kushtetuese çmon se vendimi i mësipërm është i një rëndësie të veçantë, pasi parashikon se janë organet shtetërore ato që duhet të marrin të gjitha masat, nëpërmjet veprimeve aktive, për të siguruar gjykatën se i pandehuri është njoftuar në mënyrë të rregullt, se në ngarkim të tij ka një procedim penal dhe se i pandehuri, pas këtij njoftimi të rregullt, me vullnetin e tij të lirë vendos t'i fshihet drejtësisë. Pra, ky interpretim i nenit 6 të KEDNJ-së nga ana GJEDNJ-së, përbën një garanci procedurale, më shumë për shtetasit e vendeve që kanë nënshkruar Konventën e sipërpërmendur.

41. Po të njëjtin qëndrim për detyrimin e organeve shtetërore, që të garantojnë njoftimin në mënyrë të rregullt të të pandehurit, se në ngarkim të tij ka një procedim penal, e gjejmë edhe për gjykimin *Sejdovic kundër Italisë*. Në këtë gjykim GJEDNJ-ja ka shkuar edhe më tej, duke vërejtur se: “Dhunimi i nenit 6 të KEDNJ-së ka ardhur si pasojë e keqfunksionimit të legjislacionit dhe procedurave të brendshme, shkaktuar nga mungesa e një mekanizmi efektiv që të bënte të mundur realizimin e së drejtës së personave të dënuar në mungesë, të cilët edhe të painformuar në mënyrë efektive për gjykimin në ngarkim të tyre, edhe që nuk kishin hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta për t'u mbrojtur, për të përfituar që një gjykatë tjetër të shprehet përsëri në lidhje me akuzat.”

42. Nisur nga kjo vendimmarrje e GJEDNJ-së, Republika Italiane ka ndryshuar legjislacionin e brendshëm në mënyrë që mekanizmi për të cilin flet GJEDNJ-ja të bëhej në përputhje me nenin 46 të KEDNJ-së që detyron shtetet nënshkruese të Konventës që të respektojnë vendimet e GJEDNJ-së.

43. Për sa më sipër Gjykata Kushtetuese çmon se në zbatim të nenit 46 të Konventës lind detyrimi, si për çdo shtet nënshkrues të saj, edhe për Republikën e Shqipërisë që të bëjë të



mundur lejimin e shtetasve, që efektivisht nuk kanë pasur dijeni për një procedim penal në ngarkim të tyre, të kenë të drejtën për rihapjen e procesit gjyqësor në përputhje me nenin 147 të KPr.P. Gjykata Kushtetuese çmon se ky detyrim lind edhe për të gjitha organet gjyqësore të çdo shkalle, përfshirë edhe gjykatën referuese, e cila ka detyrimin që legjislacionin e brendshëm ta aplikojë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ.

44. Gjykata çmon se e drejta e të pandehurit për të marrë pjesë në gjykim, si dhe për të zgjedhur përfaqësuesit ligjorë është një e drejtë kushtetuese vetjake, e cila nuk mund të transferohet te familjarët. Po ashtu, parashikimi në nenin 48/3 për mundësinë e familjarëve për të pajisur me prokurë mbrojtësin e të pandehurit nuk nënkupton transferimin e së drejtës për të zgjedhur mbrojtësin nga i pandehuri te familjarët, por nënkupton edhe ushtrimin e vullnetit të këtij të pandehurit, nëpërmjet familjarëve. Me fjalë të tjera, i pandehuri e ushtron këtë të drejtë vetjake nëpërmjet familjarëve të tij, të cilët kanë mundësinë objektive për të kontaktuar me avokatë, në mënyrë që këta të fundit të shqyrtojnë mundësinë për të marrë cilësinë e mbrojtësit ligjor të të pandehurit. Në këto kushte, në qoftë se ka mospërputhje ndërmjet vullnetit të të pandehurit dhe vullnetit të familjarëve të tij, që kanë keqinterpretuar vullnetin e të pandehurit ose kanë pasur një vullnet të ndryshëm për mbrojtësin ligjor, duhet të mbizotërojë vullneti i të pandehurit, i cili në çdo rast mund të refuzojë ose shkarkojë mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët.

45. Në rastin e gjykimit në mungesë, GJEDNJ-ja përcakton qartë se është detyrë e autoriteteve publike që të informojnë të pandehurin nëse ka ose jo një procedim penal në ngarkim të tij, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet siguria se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Në këtë mënyrë duhet që autoritetet shtetërore të marrin të gjitha masat e nevojshme për ta informuar të pandehurin dhe vetëm nëse janë të sigurt se ai ka marrë njoftim në formën që parashikon ligji, atëherë mund të vazhdohet me procedimin në mungesë. Pra, lejohet zgjedhja e avokatit nga ana e familjarëve vetëm nëse këta të fundit shprehin vullnetin e të pandehurit për të hequr dorë nga pjesëmarrja në proces dhe jo të investohen me këtë zgjedhje nëse nuk kanë kontakte me të pandehurin, çka, sipas GJEDNJ-së është detyrë e organeve kompetente shtetërore. E njëjta situatë është edhe për sa i përket ankimit. Familjarët e të pandehurit mund të paraqesin ankim vetëm në rast se janë duke përmbushur vullnetin e të pandehurit dhe vetëm nëse i pandehuri ka dijeni se ndaj tij ka filluar e po zhvillohet një proces penal. Në këtë mënyrë është rigoroz zbatimi i procedurave të njoftimit.

46. Duke këmbëngulur për domosdoshmërinë e njoftimit konform kërkesave ligjore dhe standardeve për këtë problem në çështjen *Sejdovic kundër Italisë*, GJEDNJ-ja u shpreh se nuk përbën provë për të vërtetuar se i pandehuri po i shmanget gjykimit nga vetë fakti se i pandehuri është larguar nga vendbanimi dhe nuk gjendet menjëherë pasi ka ndodhur vepra. Në këto kushte Gjykata duhet të pranojë mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët e të pandehurit vetëm nëse provon se ato po veprojnë në bazë të porosisë që kanë marrë nga i pandehuri. Po i njëjti arsyetim duhet të ndiqet edhe në rastin kur është një avokat i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit që kërkon rivendosjen në afat, për të ankimuar vendimin e një shkalle më të ulët. Në këtë rast gjykata duhet të hetojë nëse vërtet i pandehuri nuk ka pasur dijeni për gjykimin e zhvilluar kundër tij dhe nëse mbrojtësi ligjor i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit është zgjedhur me dijeninë e këtij të fundit.

47. Sa më lart, konform praktikës së GJEDNJ, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e paraqitur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk duhet pranuar, sepse edhe ashtu siç janë formuluar dy paragrafët e dispozitave të kontestuara, po qe se interpretohen në këtë mënyrë, shmanget mundësia e dykuptimësisë së tyre.

## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “ç” dhe 134, pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Fehmi Abdiu

Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Admir Thanza, Sokol Berberi

### VENDIM

**Nr.45, datë 7.6.2010**

## **PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELEKTRO LUBONJA” SHPK**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1 germa “a” të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, bordi i komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.06.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Elektro Lubonja” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikën 4.1.5 germat “a” dhe “c” të nenit 9, përkatësisht: Miratimi i OST-së dhe OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të tregtimit dhe leja mjedisore nga organet përkatëse është në pritje për t’u plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

### VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Elektro Lubonja” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec - Lubonjë”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA .....	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 29.6.2010

Doli nga shtypi më 30.6.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2010

Çmimi 28 lekë